

Rezultate të anketës strukturore të ndërmarrjeve ekonomike, 2013

Tiranë, më 15 dhjetor 2014: Në ndërmarrjet që operojnë në prodhuesit e të mirave dhe shërbimeve, shifra e afarizmit në vitin 2013 u rrit 6,2 % krahasuar me vitin 2012. Kontributin më të madh në rritjen e shifrës së afarizmit e japin prodhuesit e shërbimeve me 5,1 %. Me rritje paraqiten edhe treguesit e tjerë si numri i të punësuarve 9,0 %, investimet 9,2 % dhe numri i ndërmarrjeve 1,4 %.

Prodhuesit e shërbimeve realizuan 65,3 % të shifrës së afarizmit dhe zënë 85,3 % të numrit të ndërmarrjeve. Prodhuesit e të mirave kanë 37,8 % të të punësuarve dhe realizuan 56,9 % të investimeve.

Gjatë vitit 2013, ndërmarrjet aktive në sektorin e tregtisë realizuan 48,7 % të shifrës së afarizmit gjithsej dhe zënë 43,3 % të numrit të ndërmarrjeve gjithsej. Ky sektor ka përfaqësimin më të lartë në punësim me 26,0 % të të punësuarve gjithsej. Sektori i industrisë nxjerrëse ka realizuar 17,6 % të investimeve gjithsej.

Tab.1 Ndërmarrjet, të punësuarit, shifra e afarizmit dhe investimet sipas aktivitetit ekonomik, 2013

Aktiviteti ekonomik	Ndërmarrjet		Të punësuarit		Shifra e afarizmit		Investimet	
	nr.	%	nr.	%	mIn Lekë	%	mIn Lekë	%
Gjithsej	84.790	100	344.498	100	1.637.228	100	162.899	100
Prodhuesit e të mirave	12.480	15	130.068	38	568.755	35	92.750	57
Industri nxjerrëse	528	1	10.701	3	91.635	6	28.692	18
Industri përpunuese	7.912	9	68.151	20	190.749	12	28.472	17
*Energji Elektrike dhe Ujë	542	1	17.657	5	107.487	6	27.871	17
Ndërtim	3.498	4	33.559	10	178.884	11	7.715	5
Prodhuesit e shërbimeve	72.310	85	214.430	62	1.068.473	65	70.149	43
Tregti	36.674	43	89.615	26	797.103	49	24.444	15
Akomodim dhe Restorante	13.784	16	33.642	10	32.176	2	1.928	1
Transp.Komunikacion.	8.492	10	30.842	9	140.189	8	27.357	17
Shërbime të tjera	13.360	16	60.331	17	99.004	6	16.420	10


**Ndërmarrjet e prodhimit të energjisë elektrike, që janë në fazën e investimeve për studim dhe ndërtim janë klasifikuar në seksionin e prodhimit të energjisë elektrike.*

Për publikim 15/12/2014

Ndërmarrjet me 50 e më shumë të punësuar dominojnë ekonominë shqiptare. Këto ndërmarrje realizuan 60,1 % të shifrës së afarizmit. Ky grup ndërmarrjesh ka 48,5 % të të punësuarve gjithsej të aktiviteteve ekonomike të mbuluara nga kjo anketë dhe ka realizuar 66,9 % të investimeve. Në grupin e ndërmarrjeve me 50 e më shumë të punësuar mbizotërojnë prodhuesit e të mirave për numrin e ndërmarrjeve aktive, numrin e të punësuarve dhe investimeve të realizuara.


Ndërmarrjet me 1-4 të punësuar përbëjnë 89,4 % të ndërmarrjeve. Ky grup ndërmarrjesh ka realizuar 15,8 % të shifrës së afarizmit dhe ka 34,5 % të të punësuarve gjithsej. Në ndërmarrjet e vogla me 1-4 të punësuar mbizotërojnë prodhuesit e shërbimeve për numrin e ndërmarrjeve aktive, numrin e të punësuarve dhe shifrën e afarizmit të realizuar.

Fig.1 Ndërmarrjet, të punësuarit, shifra e afarizmit dhe investimet sipas madhësisë së ndërmarrjeve, 2013



Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, shprehin se shifra e afarizmit për të punësuar, për vitin 2013 ka pësuar rënie me 2,6%, si rezultat i rritjes së numrit të punësuarve (9,0 %) me një ritëm më të lartë sesa shifra e afarizmit (6.2 %).

Fig.2 Shifra e afarizmit për të punësuar sipas aktivitetit ekonomik të ndërmarrjeve, 2012-2013



Në prodhuesit e të mirave, shifra e afarizmit është rritur 2,9 % krahasuar me vitin 2012. Numri i të punësuarve u rrit 5,2 % dhe investimet u rritën 17,2 %. Numri i ndërmarrjeve aktive në prodhuesit e të mirave është rritur 3,0 %. Kontributin më të madh në shifrën e afarizmit e jep industria nxjerrëse me 3,1%.


Shifra e afarizmit për sektorët e industrisë është rritur 3,4 %, ndërsa për sektorin e ndërtimit është rritur 2,1 % krahasuar me një vit më parë. Në sektorin e industrisë nxjerrëse është shënuar rritje më e madhe e numrit mesatar të të punësuarve prej 7,5 % krahasuar me vitin 2012.

Në sektorin e industrisë përpunuese, gjatë vitit 2013, shifra e afarizmit arriti vlerën 191 miliardë lekë. Ky sektor ka 52,4 % të të punësuarve dhe realizoi 30,7 % të investimeve të ndërmarrjeve prodhuese të të mirave. Ndërmarrjet aktive të këtij sektori përbëjnë 63,4 % të numrit të ndërmarrjeve në prodhuesit e të mirave gjithsej.

Tab. 2 Ndërmarrjet, të punësuarit, shifra e afarizmit, investimet në prodhuesit e të mirave sipas madhësisë së ndërmarrjeve, 2013

Prodhuesit e të mirave	Ndërmarrjet		Të punësuarit		Shifra afarizmit		Investimet	
	nr.	%	nr.	%	mln Lekë	%	mln Lekë	%
Gjithsej	12.480	100	130.068	100	568.755	100	92.750	100
1-4 të punësuar	8.890	71	16.335	12	37.874	7	18.004	19
5-9 të punësuar	1.681	14	11.214	9	44.811	8	2.098	3
10-19 të punësuar	880	7	11.758	9	47.409	8	10.458	11
50+ të punësuar	1.029	8	90.761	70	438.661	77	62.190	67

Gjatë vitit 2013, në prodhuesit e të mirave, ndërmarrjet me 50 e më shumë të punësuar kanë realizuar 77,1 % të shifrës së afarizmit. Ky tregues është rritur 4,6 % krahasuar me vitin 2012. Numri i të punësuarve në këtë grup përbën 69,8 % të numrit gjithsej të të punësuarve në prodhuesit e të mirave, ndërsa investimet arritën vlerën 62 miliardë lekë dhe përbëjnë 67,1 % të investimeve. Për vitin 2013, numri i ndërmarrjeve është ulur 0,6 % krahasuar me vitin 2012.

Fig.3 Shifra e afarizmit dhe investimet për prodhuesit e të mirave, në miliardë lekë, 2012-2013

Shifra e afarizmit për të punësuar është ulur 2,2 % krahasuar me vitin 2012. Në sektorin e industrisë shifra e afarizmit për të punësuar është ulur 3,4 %, ndërsa në sektorin e ndërtimit ky tregues u rrit 1,8 %.

Në prodhuesit e shërbimeve, shifra e afarizmit është rritur 8,0 % krahasuar me vitin 2012. Numri i të punësuarve u rrit 11,4 %, ndërsa investimet e realizuara u rritën 0,1 %. Numri i ndërmarrjeve aktive në prodhuesit e shërbimeve është rritur 1,2 %. Kontributin më të madh në shifrën e afarizmit e jep sektori i tregtisë me 7,4 %.

Në sektorin e tregtisë, gjatë vitit 2013, shifra e afarizmit arriti vlerën 797 miliardë lekë. Ky sektor ka 41,8 % të të punësuarve në prodhuesit e shërbimeve dhe realizoi 34,8 % të investimeve të prodhuesve të shërbimeve gjithsej. Ndërmarrjet aktive të sektorit të tregtisë përbëjnë 50,7 % të numrit të ndërmarrjeve në këtë grup.


Shifra e afarizmit në sektorin e shërbimeve të tjera (arsimi dhe shëndetësia private, shërbime administrative, profesionale, shkencore dhe teknike, etj.) është rritur 10,6 % krahasuar me një vit më parë. Ky sektor ka shënuar rritjen më të lartë prej 18,7 % e numrit të të punësuarve gjithsej.

Tab. 3 Ndërmarrjet, të punësuarit, shifra e afarizmit, investimet e prodhuesve të shërbimeve sipas madhësisë së ndërmarrjeve, 2013

Prodhuesit e Shërbimeve	Ndërmarrjet		Të punësuarit		Shifra e afarizmit		Investimet	
	nr.	%	nr.	%	mln Lekë	%	mln Lekë	%
Gjithsej	72.310	100	214.430	100	1.068.473	100	70.149	100
1-4 të punësuar	66.917	93	102.547	48	221.538	21	7.765	11
5-9 të punësuar	3.243	4	20.319	9	128.620	12	9.953	14
10-19 të punësuar	1.169	2	15.367	7	172.491	16	5.665	8
50+ të punësuar	981	1	76.197	36	545.824	51	46.766	67

Gjatë vitit 2013, ndërmarrjet me 50 e më shumë të punësuar kanë realizuar 51,1 % të shifrës së afarizmit. Ky tregues është ulur 2,0 % krahasuar me vitin 2012. Numri i të punësuarve në këtë grup përbën 35,5 % të numrit gjithsej të të punësuarve në prodhuesit e shërbimeve, ndërsa investimet arritën vlerën 47 miliardë lekë dhe përbëjnë 66,7 % të investimeve.

Fig.4 Shifra e afarizmit dhe investimet për prodhuesit e shërbimeve, në miliardë lekë, 2012-2013



Shifra e afarizmit për të punësuar është ulur 3,1 % krahasuar me vitin 2012. Në sektorin e transportit dhe komunikacionit paraqitet rënia më e madhe e këtij treguesi me 7,8 % krahasuar me një vit më parë.

Metodologjia

Qëllimi kryesor i statistikave strukturore të ndërmarrjeve është të tregojë strukturën e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve ekonomike nëpërmjet të dhënave bazë. Treguesit paraqiten për aktivitetet ekonomike gjithsej, sipas degëve dhe sipas madhësisë së ndërmarrjeve. Statistikat përfshijnë gjithë ndërmarrjet aktive që prodhojnë të mira e shërbime në Shqipëri, për të gjitha format legale (nuk përfshihen aktivitetet e bujqësisë, peshkimit dhe aktivitetet financiare). Popullsia është bazuar në ndërmarrjet të cilat sipas regjistrimit statistikor janë aktive në dhjetor të vitit referues. Klasifikimi i ndërmarrjeve është bërë sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2. Të dhënat i përkasin periudhës vjetore kalendarike. Viti fiskal korrespondon me vitin kalendarik. Klasifikimi i ndërmarrjeve sipas madhësisë është bërë sipas numrit të të punësuarve (matur si të punësuar me kohë të plotë). Për ndërmarrjet me 1-9 të punësuar është marrë mostër me zgjedhje për anketim. Ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht. Grumbullimi i të dhënave është kryer me intervistim të drejtpërdrejtë pranë ndërmarrjeve.

Rezultatet e statistikave strukturore të ndërmarrjeve në mënyrë që të jenë të përshtatshme me ato të vendeve evropiane, publikohen duke zbatuar rregulloret e reja të Komisionit Evropian:

Rregulloren e Komisionit Evropian Nr.1893/2006 mbi “Implementimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2 në Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve;

Rregulloren e Komisionit Evropian Nr.295/2008 mbi “Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve”;

Rregulloren e Komisionit Evropian Nr.250/2009 mbi “Definicionet e përdorura në Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve”.

Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, 2013 publikohen për herë të parë sipas Nomenklaturës së Veprimtarisë Ekonomike Rev.2. Për më shumë informacion referohuni link-ut:

<http://www.instat.gov.al/al/publications/njoftim-për-media/njoftim-per-media-ndryshimi-i-nomenklaturës-së-veprimtarive-ekonomike.aspx>

Struktura e Aktiviteteve Ekonomike sipas dy Nomenklaturave

	NVE Rev 1.1		NVE Rev.2	Aktivitetet ekonomike të vrojuara
Seksioni	Përshkrimi	Seksioni	Përshkrimi	
A	Bujqësi, gjueti dhe silvikulturë	A	Bujqësi, pyje dhe peshkim	-
B	Peshkim			
C	Industri nxjerrëse	B	Industri nxjerrëse	Industri nxjerrëse
D	Industri përpunuese	C	Industri përpunuese	Industri përpunuese
E	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit e avullit dhe ujit të ngrohtë	D	Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	Energji Elektrike dhe Ujë
		E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	
F	Ndërtim	F	Ndërtim	Ndërtim
G	Tregti me shumicë dhe pakicë. Riparimi i automobilave i motoçikletave i sendeve personale dhe i pajisjeve shtëpiake	G	Tregti me shumicë dhe pakicë. riparimi i automobilave dhe motoçikletave	Tregti
H	Hotele dhe restorante	I	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	Akomodim dhe Restorante
I	Transport, magazinim dhe komunikacion	H	Transport dhe magazinim	Transp.Kom.
		J	Informacioni dhe komunikacioni	
J	Ndërmjetësim monetar dhe financiar	K	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	-
K	Pasuritë e patundshme, dhënia me qera, informatika, puna kërkimore shkencore, të tjera aktivitete profesionale	L	Pasuritë e patundshme	Shërbime të tjera
		M	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	
		N	Shërbime administrative dhe mbështetëse	
L	Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi social i detyrueshëm	O	Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi social i detyrueshëm	-
M	Arsimi	P	Arsimi	Shërbime të tjera
N	Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	Q	Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	
O	Aktivitete të tjera të shërbimit kolektiv, social dhe individual	R	Art, argëtim dhe zbavitje	Shërbime të tjera (përfshirë S94)
		S	Aktivitetet të tjera shërbimi	
P	Shërbime në shtëpi	T	Shërbime në shtëpi	Shërbime të tjera
Q	Aktivitetet të organizatave ndërkombëtare	U	Aktivitetet të organizatave ndërkombëtare	-

Rishikimi i të dhënave

Rezultatet paraprake të statistikave strukturore të ndërmarrjeve sipas Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve publikohen 12 muaj pas mbylljes së periudhës referuese. Rezultatet përfundimtare publikohen 14 muaj pas mbylljes së periudhës referuese.

Të dhënat paraprake deri në publikimin e rezultateve përfundimtare janë në proces rishikimi. Rishikimi nënkupton plotësimin e vazhdueshëm të të dhënave. Saktësia e të dhënave të publikuara mund të rritet si pasojë e ndryshimeve që mundësohen nga sigurimi i të dhënave të reja më të plota dhe më cilësore, të cilat kontribuojnë ndjeshëm në përmirësimin e rezultateve paraprake, të publikuara sipas afateve të parapërcaktuara në kalendarin e publikimeve.

Përkufizime të variablave bazë**Ndërmarrja**

Ndërmarrja është njësia më e vogël e kombinimit të njësisë legale me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendim-marrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrojë një ose disa aktivitete ekonomike.

Shifra e afarizmit

Shifra e afarizmit përfshin shumat e faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korrespondon me vlerën e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përjashtuar taksën mbi vlerën e shtuar.

Numri i të punësuarve

Numri i të punësuarve përfshin të gjithë personat që punojnë në ndërmarrje përfshirë pronarët, të punësuarit me pagesë si dhe pjesëtarët e familjes të papaguar.

Investimet

Investimet gjatë periudhës referuese përfaqësojnë vlerën e mallrave afatgjata të blera prej ndërmarrjeve ose të krijuara për llogari të vet me qëllim përdorimi për një periudhë jo më të vogël se 1 vit në procesin e prodhimit, përfshirë tokën.